



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Nr. 2177 Prot.

Tiranë, më 26.04 2019

Lënda: Kërkesë për plotësim dokumentacioni

Z. KLEMENT GANI ÇELA
Adresa: Kërbunarë e Madhe, Lushnjë

Për dijëni: **KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 04, Tiranë

PARTISË DEMOKRATIKE
Adresa: Bulevardi "Zhan Dark", nr. 11, Tiranë

Me shkresën nr. 792/1 prot., datë 25.02.2019, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i Deputetit, të z. Enkelejd Lutfi Alibeaj, i zgjedhur në zonën zgjedhore, Qarku Fier, propozuar nga subjekti politik, Partia Demokratike.


Referuar nenit 164, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të cilit i kalon mandati i Deputetit, është kandidati me numër rendor 15, z. Klement Gani Çela.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për çdo kandidat të listave shumëmemërore për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, për shkak të plotësimit të vakancave, duhet të kryhet vetëdeklarimi për garantimin e integritetit dhe verifikimi i të dhënave.

Përpara plotësimit të vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kandidati i listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, z. Klement Gani Çela, duhet të depozitojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 10 ditëve, formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të kandidatit.

Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit të sipërcituar, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall faktin e moszgjedhshmërisë.

Ju bëjmë me dije se formulari i vetëdeklarimit duhet të jetë i plotësuar në kompjuter, në të gjitha seksionet e tij dhe në rast se ndonjë nga pjesët e formularit nuk mund të plotësohet, për mungesë të faktit, atëherë personi duhet të shënojë me vizë (/) atë pjesë, në mënyrë që të shmangët plotësimi apo rregullimi i mëvonshëm i saj, në përputhje me kreun II, pika 7, dhe kreun III, pika 2, e vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e kushteve të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KQZ
U PROTOKOLLUA
NR. 260 PROT
DATE 30.04.19

Tiranë, më 30/04/2019

LËNDA: Kthim përgjigje njoftimit të KQZ, duke konfirmuar refuzimin për të dorëzuar Formularin e Vetëdeklarimit për Dekriminalizimin

DREJTUAR: KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

BAZA LIGJORE: Pika 2, neni 5 i ligjit nr. 138/2015

Të nderuar anëtarë të KQZ-së,

Unë, **Klement Gani Çela**, kandidat nga lista shumëemërore e Partisë Demokratike të Shqipërisë, jam njohur me njoftimin tuaj, për mandatin e deputetit dhe thirrjes për plotësimin e dokumentacionin përkatës. Në njoftim theksohet se përpara plotësimit të vakancës së krijuar në Kuvend me personin tim, unë duhet të bëjë vetëdeklarimin për garantimin e integritetit, duke plotësuar dhe dërguar brenda 10 ditëve nga momenti i njoftimit, Formularin e Vetëdeklarimit për efekt të procesit të Dekriminalizimit.

Ashtu siç ju kam bërë me dije edhe më parë, nisur nga rrethanat në të cilat ndodhet vendi, nuk pranoj zgjedhjen apo mandatin e deputetit për në Kuvendin e Shqipërisë, të cilin e konsideroj ilegjitim dhe të dalë nga një proces i deformuar zgjedhor, i diktuar nga fenomeni i blerjes së votave dhe përfshirjes së grupeve kriminale në zgjedhje.

Në këto kushte, në mbështetje të nenit 5, pika 2, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", me vullnet të lirë, deklaroj se **REFUZOJ** të dorëzojë Formularin e Vetëdeklarimit, duke refuzuar të pranoj propozimin e KQZ për kandidimin, zgjedhjen apo emërimin.

Përsa më lart, lutem ndjekjen e menjëhershme të procedurës ligjore për shpalljen e moszgjedhshmërisë time në funksionin e deputetit, në përputhje me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015.

Me respekt,
Klement Gani Çela

KLEMENT GANI ÇELA
(emër, atësi, mbiemër, nënshkrimi)